

VENDIM
Nr. 503, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 438, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI
DHE SHPËTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 438, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha